



Nr. 25 Prot.

Tiranë, më 21 Shkurt 2020

KËRKESË PËR INFORMACION

Në lidhje me kallëzimin penal ndaj shtetasit Ervin Bushati

KËRKUES: PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, në cilësinë e kallëzuesit të veprës penale, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i PDSH-së Gazment Bardhi, me adresë njoftimi "Bulevardi "Zhan D'Ark, Nr. 11, Tiranë"

DREJTUAR: PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

NË VËMENDJE: PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
AMBASADËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS
DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN
TË GJITHA AMBASADAVE TË VENDEVE ANËTARE TË BE
ZYRËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS, TIRANË

BAZA LIGJORE: Nenet 110 dhe 327 e vijues të të K.Pr.Penale

I nderuar z. Prokuror,

Më 2 Tetor 2018, Partia Demokratike e Shqipërisë, ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë një kallëzim penal për veprat penale "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve" dhe "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", parashikuar nga nenet 190 dhe 257/a i Kodit Penal, ndaj shtetasit Ervin Bushati, me funksion "deputet i Kuvendit të Shqipërisë".

Në kallëzim evidentohen faktet sesi nga verifikimi i të dhënave në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, rezulton se deputeti Ervin Bushati, ka fshehur dhe nuk ka deklaruar pronësinë për 7 pasuri të paluajtshme. Gjatë

gjithë periudhës së deklarimit 2014-2018, deputeti Ervin Bushati, rezulton se nuk ka deklaruar pasuri në emër të tij, duke bërë deklaram të rremë të pasurisë, nëpërmjet mospasqyrtimit në Deklaratat e Pasurisë, të të paktën 7 pasurive të paluajtshme. Konkretisht, rezulton se ai nuk ka deklaruar pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

1. Në Tiranë, një pasuri me sipërfaqe, 938 m² truall, e regjistruar më 21.04.2017, e padeklaruar në deklaratat periodike të vitit 2017 (depozituar në ILDKPKI më datë 29.03.2018).

2. Në Tiranë, një pasuri me sipërfaqe, 600 m² truall, me sipërfaqe ndërtimi 327 m², e regjistruar më 21.04.2017, e padeklaruar në deklaratat periodike të vitit 2017 (depozituar në ILDKPKI më datë 29.03.2018).

3. Në Tiranë, një pasuri me sipërfaqe, 938 m² truall, e regjistruar më 25.07.2014, e padeklaruar në deklaratat periodike të vitit 2014 (depozituar në ILDKPKI më datë 24.03.2015).

4. Në Qerret, Kavajë, një pasuri me sipërfaqe 76 m², ndërtesë, e regjistruar më 30.05.2016, fituar me kontratë shitje nga shteti (ALUIZNI), e padeklaruar në deklaratat periodike të vitit 2016 (depozituar në ILDKPKI më datë 29.03.2017).

5. Në Qerret, Kavajë, një pasuri me sipërfaqe 376 m² truall, e regjistruar më 30.05.2016, fituar me kontratë shitje nga shteti (ALUIZNI), e padeklaruar në deklaratat periodike të vitit 2016 (depozituar në ILDKPKI më datë 29.03.2017).

6. Në Sarandë, një pasuri me sipërfaqe 660 m² truall, e regjistruar më 17.07.2014, e padeklaruar në deklaratat e vitit 2014-2018.

7. Në Sarandë, nuk ka në pronësi 12 garazhe siç ka deklaruar, me sipërfaqe secila 42 m², por ka në pronësi 13 garazhe. Pra, në deklaratën e vitit 2014, ka fshehur pronësinë për 1 garazh, me sipërfaqe 42 m².

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, më datë 25.10.2018, vendosi "mosfillimin e procedimit penal", me argumentin se nuk ka njoftim nga ILDKPKI për këtë rast! Pas ankimit të Partisë Demokratike ndaj këtij vendimi të organit të prokurorisë, në Janar 2019, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, vendosi shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 10.10.2018 "Për mosfillimin e procedimit penal që i përket materialit kallëzues Nr. 13118 të vitit 2018", duke detyruar Prokurorinë që të regjistronte procedim penal për rastin në fjalë.

Sot, në më shumë se 1 vit nga momenti ku gjykata konstatoi se kallëzimi ishte bazë e mjaftueshme për regjistrimin e procedimit penal ndaj shtetasit Ervin Bushati, organi i prokurorisë nuk ka konkluduar për përfundimin e hetimeve

mbi këtë çështje dhe nuk ka dalë në një vendimmarrje mbi këtë dosje hetimore. Ne shprehim indinjatën tonë të thellë për mungesën e veprimit nga ana e organit të prokurorisë me këtë dosje, që po siguron pandëshkushmërinë e zyrtarëve të lartë.

Duke qenë se në cilësinë e kallëzuesit nuk kemi asnjë informacion në lidhje me gjendjen e këtij procedimi penal, dhe bazuar në faktin se edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit, prokuroria nuk ka konkluduar mbi këtë çështje penale, duke mos kryer/përfunduar hetimet e nevojshme sipas ligjit dhe vënien përpara përgjegjësisë penale të autorëve, në mbështetje të nenit 110 të K.Pr.Penale, ku parashikohet se: *"Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim"*,

KËRKOJMË:

- 1. Informacion në lidhje me gjendjen e procedimit penal, lidhur me kallëzimin Nr. 13118 të vitit 2018 kundër shtetasit Ervin Bushati.**
- 2. Informacion nëse Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pas datës 19 Dhjetor 2019, ka shpallur apo jo moskompetencën dhe a i janë kaluar aktet Prokurorisë së Posaçme SPAK, duke qenë se shtetasi Ervin Bushati, është deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe është subjekt hetimi nga SPAK, si dhe;**
- 3. Në përputhje me të drejtën që na njeh ligji, të njihemi me provat dhe aktet e administruara për këtë procedim deri në këtë moment.**

Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj sipas ligjit.

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga:

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
GAZMENT BARDHI**

